




## Super këshillë !


Në çfarëdo shkolle e niveli të studioni, duhet të jepni më te mirën tuaj: Më të mirët punësohen të parët, marrin punë më të mira dhe rrogat më të larta.


 Në qoftë se ju / fëmija juaj është student i/e shkëlqyer dhe dëshiron të gjejë një punë të mirë menjëherë pas Universitetit, sugjerojmë të studiojë Financë & Auditim & Sigurim. Megjithatë për shkak të numrit të ulët të posteve të disponueshme, duhet të merrni parasysh konkurrencën e fortë, të pasuar me një periudhë të gjatë të trajnimit në kompani.


 Në qoftë se ju / fëmija juaj është shumë i mirë në matematikë / shkencat ekzakte / dëshiron kontaktin social dhe të udhëtoje ai / ajo duhet të studiojë për inxhinieri. Gjetja e një punë për inxhinjerë të sapo-diplomuar pritet të jetë krahasimisht më e lehtë, paga e fillimit do të jetë e konsiderueshme dhe rruga e karrierës e qëndrueshme.


 Inxhinieria & financa duket të jenë profesionet e paguara më mirë për të sapo-diplomuarit. Megjithëse parashikohet të ketë më tepër punë për inxhinjerë se sa për bankierë.


 Në qoftë se ju / fëmija juaj dëshiron të fillojë punë menjëherë pas shkollës së mesme, nqs. studion VET (Edukim dhe Trajnim Profesional) ka më tepër shanse për të gjetur punë se nqs studion arsim të përgjithshëm. Për më tepër, nqs ndërron mendje studimet në VET e lejojnë të vazhdojë më lart drejt arsimit të lartë profesional. Shumica e investitorëve të huaj në Shqipëri janë të interesuar të punësojnë të rinj me formim VET.


 Ju / fëmija juaj duhet të bëjë maksimumin për të marrë përvojë pune gjatë kohës së studimeve.

 Pas diplomimit është më mirë që ju / fëmija juaj të punoni / jë se sa të presë për të gjetur punën e duhur – çdo përvojë pune është asset në karrierën e fillestarëve.

 Ju / fëmija juaj nuk duhet të tutet nga ndryshimi i vendeve të punës. Në tregun e sotëm, ky është një fenomen normal

 Përshtatshmëria është një nga tiparet më të kërkuara në tregun e punës. Shumë punëdhënës do të punësojnë ju / fëmijën tuaj për detyra të thjeshta fillestare në nivel të ulët. Do të jetë në dorën tuaj / fëmijës tuaj për të provuar se vleni më shumë dhe të orientoni karrierën tuaj në rrugën e dëshiruar

 Formimi Profesional nuk duhet të shihet si një alternativë ndaj gjimnazit por si një zgjedhje karriere përballë universitetit. VET mund t'ju cojë më vonë në studime master në mjeshtëri profesionale / jo-akademike (i cili në Gjermani është i njëjtë me nivelin bachelor). Kjo gjithashtu kërkon një standard më të lartë të shkollave profesionale

 Shqipëria nuk është i vetmi vend në të cilin ju / fëmija juaj mund të keni një punë fillestare të suksesshme. Përdisa profesione si: infermierët, kujdesi social, inxhinjerë, IT, etj - kanë një kërkesë të lartë në vendet e tjera evropiane ose në vende me rritje të lartë ekonomike si në Gjirin Persik. Ju duhet të mbani këtë në mendje kur planifikoni karrierën tuaj / të fëmijës tuaj.

# TRENDET E PUNËSIMIT RINOR NË SHQIPËRI: ÇFARË KËRKON TREGU?

**Fakt 1.** Vetëm një në pesë ndërmarrje nuk kërkon asnjë kualifikim / diplome për të të marrë në punë. Gjysma e punëdhënësve kërkon të paktën të keni shkollën e mesme, ndërsa gati 1/3 e tyre kërkon nga ju diplomë universitare.

**Fakt 2.** Në rang vendi individët me shkollim VET preferohen dy herë më shumë nga punëdhënësit, se sa të rinjtë me arsim të mesëm të përgjithshëm: 19,2% vs.10,5%. (për ndërmarrjet e mëdha shkollimi VET preferohet rreth pesë herë më tepër se gjimnazi nga për profilin e të punësuarve: 12,8% vs. 2,6%).

**Fakt 3.** Personat me shkollim VET kanë nivelin më të ulët të papunësisë me 13,9%; ata me arsim universitar 19,8%; dhe të shkolluarit me arsim të mesëm të përgjithshëm 24,3%.

**Fakt 4.** Po e patët vendosur për tu shkolluar në VET, punëdhënësit e mëdhenj në "Industrinë Përpunuese" do të punësojnë katër në çdo 10 të rinj në vitet e ardhshme. Po e patët vendosur për të shkuar në Universitet duhet të dini se ¾ (72,7%) e punëdhënësve më të mëdhenj planifikojnë të punësojnë të paktën nga një Inxhinier.

**Fakt 5.** Më tepër se gjysma e kompanive ne vend përdorin lidhje familjare dhe miqësore për të rekrutuar. Shfrytëzoni lidhjet familjare dhe të rrethit të ngushtë për të kërkuar dhe gjetur punën tuaj të parë.


**Fakt 6.** Rrogat më të larta paguhen nga kompanitë e mëdha. Këto kompani planifikojnë të punësojnë inxhinjerë. Po synuat rroga të mëdha, perspektiva të mira punësimi, dhe të jeni të zotët në shkenca egzakte, studioni për inxhinjeri.

**Fakt 7.** Më shumë se dy të tretat e të rinjve (70.8%) nuk punësohen për më gjatë se 12 muaj në një vend pune. Mos u dekurajoni ! Sot në treg është normale të ndërrosh shpesh punë në fillim të karrierës.


**Fakt 8.** Në ¼ e ndërmarrjeve në vend, ka të rinj që ndjekin studimet, krahas punësimi. Sa më e madhe ndërmarrja, aq më shumë ajo punëson të rinj që edhe studiojnë. Fillimi i punës nuk shënon fundin e studimeve. Madje punësimi krahas studimeve është një aset i çmuar për një karrierë të suksesshme.

**Fakt 9.** Ndërmarrjet me 1 - 4 të punësuar përbëjnë 89% të ndërmarrjeve shqiptare. Mendoni të krijoni ndërmarrjen tuaj ! Për të nisur aktivitete si IT, kujdes social, infermierë, hidraulik, elektrikistë, etj, nuk keni nevojë për kapital të madh financiar. Për me tepër që për profesionet e caktuar ka kërkesa pune dhe në vendet e huaja. Por duhet të keni diploma dhe mjeshtëri të shkëlqyera.


**Fakt 10.** Më tepër se 57% e të punësuarve në Shqipëri, janë në sektorin e bujqësisë. Bujqësia sot po evoluon drejt një sektori modern në harmoni me mjedisin. Nëse jetoni në zona rurale ose planifikoni të jetoni pranë natyrës, bujqësia mund të jetë e ardhmja që kërkon.




Fakt 2



Fakt 3



Fakt 5



Fakt 6



Fakt 9